



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr.8098, datë 28.3.1996

PER STATUSIN E TE VERBERIT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

VENDOSI:

NENI 1

Përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësore janë të paaftë për punë në kushte normale.

NENI 2

Shteti dhe shoqëria marrin në mbrojtje personat e verbër dhe krijojnë të gjitha kushtet për integrimin e tyre në jetën normale. Me integrim kuptohet pjesëmarrja aktive duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

- a) krijimin e kushteve të përshtatshme për banim, të sipërfaqes së banimit dhe të pajisjeve të zakonshme dhe speciale;
- b) punësimin në kushte të favorshme e me përparësi, duke përcaktuar profesionet e mbrojtura me ligj;
- c) risistemimi në punë i atyre të verbërve që për arsye të ndryshme janë pushuar ose kanë humbur punën dhe gjatë kësaj kohe marrin një shpërblim të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave;

- ç) përcaktimin e fondeve për depistimin dhe ridiagnostikimin nga klinikat okulistike të sistemit të shërbimit shëndetësor shtetëror nën mbikëqyrjen dhe me ndihmën e specialistëve të huaj të klinikave të përparuara perëndimore, si dhe krijon kushte të favorshme për mjekimin e syve dhe sëmundjeve të tjera të lindura apo të fituara.

NENI 3

Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta.

NENI 4

Të verbërit përjashtohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur ata kryejnë veprimtari private si persona juridikë.

NENI 5

Pavarësisht nga të ardhurat e tjera që përfitohen nga shteti, të verbërit marrin një shtesë për shkak të verbërisë së tyre në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave e cila nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekt varfërie. Po në këtë masë pagesën e përfiton edhe kujdestari i tyre, të cilin e zgjedhin vetë.

NENI 6

Personat juridikë shtetërorë apo privatë që punësojnë të verbërit, përveç kritereve të përcaktuara në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", përfitojnë ulje në tatimin mbi fitimin të barabartë me përqindjen e fuqisë punëtore të verbër.

NENI 7

Këshillat e Rregullimit të Territorit dhe organet e urbanistikës nuk miratojnë asnjë projekt për rrugët e mjediset publike, në qoftë se në to nuk janë mbajtur parasysh përshtatjet e nevojshme dhe të mundshme të tyre për të verbërit. Shteti kujdeset për strehimin e të verbërve, duke siguruar veçanërisht për të verbërit e grupit të parë, ose që barazohen me ta, një dhomë mbi kubaturën normale dhe përshtatjen e saj në raport me kushtet fizike. Enti Kombëtar i Banesave përballon shpenzimet për blerjen dhe përshtatjen e banesës që përfitojnë të verbërit.

NENI 8

Arsimimi i të verbërve në sistemin shtetëror bëhet falas, kurse pranimi i tyre në arsimin e zakonshëm bëhet me kriterë të veçanta të përcaktuara nga Ministria e Arsimit. Gjatë kohës së studimit në arsimin e mesëm, universitar ose pasuniversitar, si dhe gjatë periudhës së kualifikimit, të verbërit përfitojnë pagesën e vendosur nga Këshilli i Ministrave. Ata me gradë shkencore këtë pagesë e përfitojnë në mënyrë të përhershme. Këshilli i Ministrave merr masa dhe përcakton fonde për ngritjen e shkollave dhe institucioneve për arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e të verbërve.

NENI 9

Shteti bën sigurimin shëndetësor të të verbërve falas, si dhe përfitimin e ilaçeve dhe pajisjeve ndihmëse mjekësore falas, deri në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit përcakton listën e pajisjeve ndihmëse.

NENI 10

Këshilli i Ministrave merr masat dhe përcakton fondet për ndërtimin e dy qendrave të pushimit bregdetare dhe malore me kapacitet të mjaftueshëm për numrin e të verbërve në Shqipëri. Administrimi i tyre bëhet nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë dhe subvencionohet nga shteti në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Në funksion të çlodhjes dhe argëtimit shteti përkrah veprimtarinë kulturore të të verbërve, si dhe u siguron falas hyrjen në mjediset kulturore.

NENI 11

Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat.

NENI 12

Të gjithë të verbërit, të paaftë për të lëvizur pa shoqërues, në kushte fizike të invaliditetit të grupit të parë, pajisen me telefon. Ata paguajnë tarifë telefonike të nivelit të parë të favorizuar për popullsinë, e përcaktuar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke u përjashtuar nga tarifat e tjera, diferencat paguhen nga shteti. Të gjithë personat e verbër, sipas nenit 1 të këtij ligji, paguajnë 20 për qind të vlerës së konsumit mujor të energjisë elektrike, diferencat paguhen nga shteti.

NENI 13

Shteti mbron dhe përkrah Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë.

Ai i njej asaj rolin aktiv në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve, duke e trajtuar si palë konsultative në hartimin e ligjeve e akteve nënligjore, si dhe zgjidhjen e problemeve të të verbërve.

Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim.

Shteti vë në dispozicion të Shoqatës së të Verbërve mjedise pune në qendër dhe në rrethe, të cilat ua jep në përdorim.

NENI 14

Asnjë organ nuk ka të drejtë të japë të dhëna për gjendjen e invaliditetit të një personi pa pëlqimin e këtij të fundit.

NENI 15

Personat e verbër të përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji përfitojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në ligjin nr.7889, datë 14.12.1994 "Për statutin e invalidit".

NENI 16

Paditë e ngritura në gjykatë për mozbatimin e këtij ligji shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar. Shpenzimet përballohen nga shteti.

NENI 17

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministritë përkatëse të nxjerrin akte nënligjore në zbatimin e këtij ligji.

NENI 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1458, datë 9.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr.277, date 18.6.1997

PER

PERFITIMET NGA STATUSI I TE VERBERIT

Ne zbatim te ligjit nr.8098, date 28.3.1996 "Per statusin e te verberit", me propozimin e Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjithe personat qe perfitojne nga ligji nr.8098, date 28.3.1996, i nenshtrohen gjykimit te KMCAP te rrethit perkates. Keto komisione jane te detyruara te shqyrtojne kerkesat e te interesuarve, pavaresisht nga mosha dhe fakti nese jane ose jo ne marredhenie pune, per te percaktuar shkallen e aftesise se tyre per pune.

Grupet e paaftesise per pune jane:

- a) grupi i pare, ne te cilin futen te verber te paafte per pune ne kushte normale, por qe kane nevoje per kujdestar;
- b) grupi i dyte, ne te cilin futen te verber te paafte per pune ne kushte normale, por qe jane ne gjendje t'i sherbejne vetes.

KMCAP, ne percaktimin e grupit te aftesise per pune per te verberit, asistohet nga nje perfaqesues i Shoqates se te Verberve te Shqiperise.

2. KMCAP i leshon te interesuarit raportin mjekesor, duke percaktuar shkallen e paaftesise, perqindjen e shikimit, si dhe nevojen per kujdestar. Personi i verber i grupit te pare duhet te deklaroje emrin e kujdestarit para administratorit shoqeror qe e regjistron ate ne nje regjister te posaçem. Nderrimi i kujdestarit mund te behet sa here qe personi i verber e çmon te arsyeshme, por ai eshte i detyruar te informoje menjehere KMCAP.

3. Shoqata e te Verberëve te Shqiperise leshon librezen e verberise si dokument prove per perfitimin nga ligji nr.8098, date 28.3.1996, e cila nuk eshte e njejte me librezen e anetaresise. Librezat e verberise jepen vetem kur kryesise se Shoqates se te verberëve te Shqiperise i vihen ne dispozicion nga Drejtoria e Pergjithshme e Sigurimeve Shoqerore raportet mjekesore te leshuara nga KMCAP dhe dokumentacionin tjeter te nevojshem, per çdo person. Modeli i librezes se verberise percaktohet nga Ministria e Punes dhe e Çeshtjeve Sociale, ne bashkepunim me Shoqaten e te Verberëve te Shqiperise.

4. Masa e pageses per shkak te verberise eshte 70% e pageses minimale shteterore dhe do te perfitohet pavaresisht nga mosha dhe te ardhurat e tjera qe perfitohen nga shteti. Ne te njejten mase perfitojne edhe kujdestaret e te verberëve te grupit te pare, nevojat per te cilet percaktohet nga KMCAP. Me keta kujdestare personat e verber nenshkruajne nje kontrate para noterit dhe ia paraqesin administratorit shoqeror. Keto pagesa do te behen çdo muaj nga zyrat e perkrahjes sociale te bashkive dhe komunave ku te verberit kane vendbanimin e tyre te perhershëm. Fondet per keto pagesa do te nxirren nga Administrata e Pergjithshme te Ndihtes te Sherbimeve Sociale per vitin 1997 dhe do te planifikohen rregullisht per vitet e ardhshme.

5. Gjithe personat e verber qe kane humbur vendin e punes per arsye te ndryshme pas 1 janarit 1991, perfitojne 150% te vleres se percaktuar ne piken 4 te ketij vendimi deri ne sistemimin e tyre ne pune.

Risistemimi i tyre ne pune behet me perparesi nen kujdesin dhe mbikeqyrjen e Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale e te strukturave te saj perkatese.

Ngarkohen Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Arsimit te Larte dhe Kerkimeve Shkencore, Ministria e Shendetesise dhe e Mbrojtjes se Ambientit qe, brenda gjashte muajve nga dalja e ketij vendimi, te perfundojne nje studim dhe te paraqesin propozimet konkrete per ngritjen e institucioneve te rehabilitimit, pergatitjen profesionale, si dhe sistemimin ne pune te te verberëve. Ne kete zgjidhje do te mbahen parasysh edhe sugjerimet e Shoqates se te Verberëve te Shqiperise.

6. Personave juridike shteterore dhe private qe trajtojne personat e verber per shpenzimet per energjine elektrike dhe telefonike u zbriten diferencat e pagaesave te bera per te verberit nga detyrimet qe ata i paguajne shtetit. Departamenti i Postave dhe Telekomunikacioni brenda nje muaji nga dalja e ketij vendimi, te percaktoje tarifen per çdo impuls pa tatim dhe ngarkesa te tjera, e cila duhet te jete e barabarte me çmimin e impulsit te paguar nga popullsia per 200 impulset e para te pageses mujore qe eshte aplikuar me 22 maj 1996.

Lehtesite per pagesen e energjise elektrike do t'i behen personit te verber qe ka kontraten perkatese, kurse kur kontrata eshte ne emer te nje pjestari

tjeter te familjes se te verberit, si baba, nene ose femije, kontraktuesi duhet te paraqese certifikaten familjare te bashkejeteses me te verberit te sigluar nga administratori shoqeror dhe te vertetuar nga kryetari i bashkise ose i komunes. Lehtesite ne pagesat per energji elektrike dhe shpenzimet telefonike behen vetem per nevojat familjare te perditshme.

7. Nxenesit e verber qe vazhdojne shkollat e mesme ose kurse kualifikimi, perfitojne dyfishin e pageses per shkak te verberise, kurse studentet e shkollave te larta dhe ata qe jane perfshire ne studimet pasuniversitare, si dhe kane mbrojtur graden doktor i shkencave, perfitojne trefishin e pageses per shkak te verberise, te percaktuar ne piken 4 te ketij vendimi.

Keto pagesa do te behen vetem kur vazhdimi i shkollave ose i kurseve vertetohet nga titullaret e shkollave te mesme apo te larta dhe jo me shume se nje vit nga cikli normal i studimit. Pagesa per shkak te grades shkencore eshte e perhershme dhe behet mbi bazen e deshmise se leshuar nga organet kompetente. Fondet per kete pagese transferohen nga buxheti i Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale prane institucionit perkates ku ndodhet perfituesi, mbasi te jene plotesuar praktikata perkatese dhe te jene konfirmuar nga kryesia e Shoqates se te Verberve te Shqiperise.

8. Per ridiagnostikimin dhe depistimin e personave te verber ne Shqiperi, Ministria e Shendetesise dhe e Mbrojtjes se Ambientit, ne bashkepunim me Shoqaten e te Verberve te Shqiperise, harton nje program me afata trevjeçar. Ky program realizohet nen mbikeqyrjen dhe me ndihmen e specialisteve te huaj te klinikave te perparuara te vendeve perendimore. Fondet per vitin 1997 do te nxirren nga buxheti i Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes se Ambientit, kurse per vitin 1998-1999 do te parashikohen si ze me vete ne kete buxhet.

Çmimet e ilaçeve dhe pajisjeve do te paguhen deri ne 50% te vleres.

Brenda vitit 1997 Ministria e Shendetesise dhe e Mbrojtjes se Ambientit, ne bashkepunim me Shoqaten e te Verberve te Shqiperise, do te percaktoje listen e pajisjeve ndihmese qe do te jene me çmim te favorizuar.

9. Bashkite dhe komunat ngarkohen te zgjidhin me perparesi problemin e strehimit te te verbereve te grupit te pare. Ngarkohet Ministria e Puneve Publike, Rregullimit te Territorit dhe te Turizmit te percaktoje burimet e fondeve, si dhe menyren e pageses ne Tirane dhe ne rrethe per te verberit qe do te perfitojne banese nga Enti Kombetar i Banesave sipas ligjit nr.8098 date 28.3.1996.

10. Udhetimi ne transportin e brendshem shteteror dhe privat per personat e verber behet me 0% te tarifave per transportin urban dhe 50% te

tarifave per transportin interurban. Kete tarife e perfiton edhe shoqeruesi i te verberit te grupit te pare.

11. Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale, duke mbajtur parasysh edhe propozimet e Shoqates se te Verberve te Shqiperise, percakton nevojat per fondet per ndertimin e Qendres Kombetare te te Verberve te Shqiperise ne Tirane dhe qendrave pushimore bregdetare dhe malore. Ajo i propozon Keshillit te Ministrave nje program te caktuar per zgjidhjen e kerkesave te neneve 10 dhe 13 te ligjit nr.8098 date 28.3.1996, i cili realizohet brenda 3 vjeteve nga dalja e ketij vendimi.

12. Masa e financimit per Shoqaten e te Verberve te Shqiperise percaktohet nga Ministria e Financave, kurse per deget e saj ne rrethe nga keshillat e rretheve perkatese.

13. Efektet financiare per perfitimet nga neni 6 i ketij vendimi fillojne qe me hyrjen ne fuqi te ligjit n.8098 date 28.3.1996 "Per statusin e te verberit".

14. Te verberit kane perparesi ne radhe dhe ne sherbime publike, si dhe ne zgjidhjen e problemeve.

15. Per çdo shperdorim ne favoret dhe lehtesite e bera nga ligji, personit pergjegjes i merret libreza per nje periudhe deri ne 3 vjet, denohet me gjobe per kundervajtje administrative sipas dispozitave ne fuqi dhe, kur eshte rasti, organi qe e konstaton shkeljen, ben denoncim per ndjekje penale.

16. Ngarkohen ministrite perkatese te nxjerrin aktet nenligjore ne zbatim te ligjit dhe ketij vendimi.

17. Vendimet e Keshillit te Ministrave nr.311, date 11.7.1994, dhe nr.457 date 21.8.1995, me hyrjen ne fuqi te ketij vendimi, nuk zbatohen me per te verberit.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

SEKRETARI I PERGJITHSHEM

EKREM KASTRATI

**KRYETARI I KESHILLIT
TE MINISTRAVE**

BASHKIM FINO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 301, datë 27.6.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.7.1997
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8089, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim:

1. Paragrafi i parë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë vijon:
"Masa e pagesës për shkak të verbërisë është 6 000 lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat që përfitohen nga shteti."
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2002 për pagesën e paaftësisë, miratuar për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2002.

KRYEMINISTRI

PANDELI MAJKO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 671, datë 15.12.2000

I ndryshuar me VKM nr. 221, date 10.04.2003,
“PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT MJEKSOR TE
PERCAKTIMIT TE VERBERISE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8089, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", me propozimin të ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit Mjekësor të Percaktimit të Verberisë (KMPV), për percaktimin e personave që përfitojnë nga statusi i të verbërit. Komisioni e ka qendren në Tiranë dhe është në vartësi të Shërbimit Social Shtetëror. Numri, përberja dhe menyra e funksionimit të komisionit të percaktohet nga ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.
2. KMPV-ja kryen detyrat dhe ka të drejtat e percaktuara për KMCAP-ne, sipas vendimit nr.277, datë 18.06.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimin nga statusi i të verbërit”.
3. Branda 6 muajve nga hyrja e fuqi e këtij vendimi, të perfundojnë procedurat e kalimit të përgjegjesive nga KMCAP në KMPV. Ngarkohet drejtori i Shërbimit Social Shtetëror të normoje dhe të kontrollojë procesin e kalimit të këtyre përgjegjesive.
4. Kriteret mjeksore, për përfitimin nga “statusi i të verbërit” janë të veçanta dhe percaktohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe nga Ministria e Shëndetësisë.

5. Pagesa e mjekeve dhe e anetareve te tjera te komisionit, te behet ne baze te pjesemarrjes ne çdo komision dhe, perkatesisht, per kryetarin e komisionit ne masen 23 per qind, ndersa per anetaret e komisionit 20 per qind te pages mujore, sipas struktures se pagave te percaktuar ne vendimin nr.306, date 27.06.2002, te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e struktures dhe te nivelit te pagave te punonjesve me arsim te larte ne sistemin e Ministrise se Shendetsise", kreu I.1, lidhja nr.1, emertimi "mjek" por jo me shume se nje page mujore e ketij emertimi. Komisioni mblidhet jo me shume se kater here ne muaj".
6. Efektet financiare, qe rrjedhin nga pagesat per KMPV-ne, te perballohen nga fondi i Sherbimit Social Shteteror.
7. Ne vendimin nr.277, date 18.06.1997, te Keshillit te Ministrave, "Per perfitimet nga statusi i te verberit ", behet ndryshimet si vijon:
 - a) "kudo ne vendim ku permendet KMCAP" (te rrethit perkates) te zevendesohet me KMPV".
 - b) paragrafi i pare, pika 3 te riformulohet:
"Shoqata e te verberit te Shqiperise leshon librezin e verberise, si dokument prove per perfitimin nga ligji nr. 8098, date 28.03.1996, e cila nuk eshte e njejte me librezin e anetaresise. Librezat e verberise jepen vetem kur Kryesise se Shoqates te se Verberve te Shqiperise i vihet ne dispozicion nga KMPV-ja, raportet mjeksore dhe dokumentacioni tjetër, i nevojshem per çdo person".
8. Ngarkohet Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

ILIR META



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale

UDHËZIM

Nr. 1766/1, datë 17.09.2003

**Ndryshuar me Udhezimin Nr. 1281, date 15.07.2004,
Udhezimin Nr. 1281/1, date 15.09.2004 dhe
Udhezimin Nr. 1956 date 19.09.2006. “Për zbatimin e VKM
Nr. 277, datë 18.06.1997, “Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit”,
ndryshuar me VKM Nr. 301, datë 27.06.2002”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të Vendimi Nr. 277, datë 18.06.1997, ndryshuar me VKM Nr.301, datë 27.06.2002 si dhe VKM Nr. 588 date 28.08.2003 “per caktimin e pages minimale ne shkalle vendi:

Udhëzojmë:

1. Personat që plotësojnë kërkesat e Ligjit të mësipërm, duhet të paraqesin kërkesën e tyre për trajtim pranë Seksionit të Ndihmës Ekonomike dhe të Përkujdesit Shoqëror në Njësinë Administrative, ku ata janë banorë të rregjistruar sipas gjendjes civile.
2. Krahas kërkesës për trajtim, pretenduesi duhet të paraqesë edhe dokumentat e tjera si më poshtë:
 - Çertifikatë personale me fotografi.
 - Vendimin mjekësor të lëshuar nga KMCAP ku të jetë përcaktuar
 - Shkalla e paaftësisë (grupi i parë ose i dytë)
 - Përqindja e shikimit
 - Nevoja për kujdestar.

- Kopje të Librezës së verbërisë, e lëshuar nga “Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, e cila noterizohet sa herë që personi i verbër komisionohet. Kur vendimi i KMCAP është një herë e përgjithmonë, librezat noterohet në fillim, pastaj paraqitet çdo vit e fotokopjuar, por e panoteruar:
 - Kopjen e Librezës së punës të noteruar ose vërtetimin e arkivit, kur ai ka qenë në marrëdhënie pune me kooperativën bujqësore.
 - Deklaratën noteriale mes të verbërit dhe kujdestarit si dhe adresën e kujdestarit.
 - Çertifikatën familjare, kur kujdestari i të verbërit është pjesëtar i familjes.
 - Çertifikatë të kujdestarit me fotografi, kur kujdestari është i zgjedhur jashtë familjes.
3. Si kujdestar i personit të verbër mund të jetë prindi i tij, një pjesëtar tjetër i familjes ose person i zgjedhur nga i verbëri, me kusht që kujdestari të ketë zotësi të plotë për të vepruar (kujdestari duhet të pajiset me raport mjekësor, i cili duhet të përsëritet çdo vit).
 4. Nëse personi i verbër nuk ka zotësi të plotë për të vepruar, kujdestari i të verbërit zgjidhet nga prindi ose kujdestari ligjor në ngarkim të të cilit është i verbëri. Kur prinderit janë të divorcuar kujdestari përcaktohet nga prindi të cilit me vendim gjykatë i është besuar përgjegjësia ndaj tij.
 5. Masa e për fitimit për shkak të verbërisë, përcaktuar në pikën 4 të VKM Nr 277, datë 18.06.1997, (i ndryshuar) është 8000 leke në muaj. Masa e përfitimit për kujdestarinë është e njëjtë pra 8.000 leke në muaj.
 6. Pagesa e për fitimit për shkak të verbërisë si dhe ajo e për fitimit të kujdestarise bëhet çdo muaj. Tërheqja e parave mund të bëhet nga vetë i verbëri, kujdestari me dokument identiteti ose çertifikatë me fotografi. Kur i verbëri dhe kujdestari i tij mungon atë here pagesa mund të tërhiqet nga një pjestar tjetër i familjes i pajisur me prokurë.
 7. Nxënësit e verbër që vazhdojnë shkollat e mesme ose kurse kualifikimi për fitojnë dyfishin e pagesës së përcaktuar në pikën 4 të VKM 277 datë 18.06.1997, (te ndryshuar), pikerisht 16.500 leke në muaj.
 8. Kur i verbëri ndjek arsimin e lartë dhe kursin e kualifikimit njekohesisht për fitojnë vetëm njëherë nga pagesat e përcaktuara në pikën 4 të VKM 277 datë 18.06.1997 dhe pikerisht 24.800 lekë në muaj.
 9. Studentë e verbër që përfshihen në studimet pasuniversitare si dhe kanë mbrojtur gradën “Doktor i shkencave” përfitojnë trefishin e pagesës për shkak të verbërisë të përcaktuar në pikën 4 të VKM Nr 277 datë 18.06.1997 dhe pikerisht 24.800 leke në muaj.
 10. Për për fitimin e pageses për shkak të verbërisë, të verbërit që vazhdojnë shkollat e mesme dhe të larta me dhe pa shkeputje nga puna, kur cikli normal shkollor është 4 vjet dhe i verbëri për serit një vit shkollor, ai ka të

drejtë ta marr pagesën e verbërise vetëm nje vit me shume se kohezgjatja e ciklit normal (dmth, 5 vjet).

11. Për për fitimin e pageses për shkak të verbërise, të verbërit qe vazhdojnë shkollat e mesme dhe të larta me dhe pa shkeputje nga puna, duhet të paraqesin këto dokumenta :
 - ☞ Vërtetim të firmosur nga titullari dhe sekretari i shkolles i cili të përmbaje, emrin e për fituesit, llojin e arsimit qe ndjek, vitin shkollor nese është cikel normal me korrespondence apo i përsëriur.
 - ☞ Vërtetim të firmosur nga titullari dhe sekretari i shkolles për frekuentimin e shkolles nga për fituesi për çdo 3-muaj, për të verbërit qe vazhdojnë shkollën me korespondence vertë tim qe ka shlyer detyrimet para çdo sezoni.
 - ☞ Kopjen e noterizuar të dëftesës së shkollës të çdo viti për shkollën e mesme dhe kopjen e noterizuar të diplomes në mbarim të shkolles së lartë.
12. Për për fitimin e pageses për shkak të verbërise, të verbërit qe ndjekin kurset e kualifikimit duhet të paraqesin keto dokumenta:
 - ☞ Vërtetim nga institucioni qe organizon kursin, ku të jetë përcaktuar emri i kursantit, lloji i kursit dhe kohzgjatja e tij.
 - ☞ Vërtetim për frekuentimin e kursit, kur ai zgjat mbi 6-muaj, vertetimi paraqitet çdo 3-muaj.
 - ☞ Kopja e noterizuar e dëshmise së kursit në mbarim të tij.
13. Për për fitimin e pageses për shkak të verbërise, të verbërit qe kane fituar graden “Doktor i Shkencave” duhet të paraqesin si dokument shtese origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton dhënien e gradës shkencore.
14. Të gjithë përsonat e verbër që kane punuar ne ndermarje shtë rore ose koopër ative bujqesore para Janarit 1991 dhe humbasin vendin e punes pas janarit 1991, për fitojnë 150 % të vleres se për cakuar ne piken 4 të VKM Nr.277 datë 18.06.1997 (kur ketë e vertetojnë me paraqitjen e librezes se punes të fotokopjuar dhe të noterizuar, ose (vertetim nga arshiva kur të verbërit kane punuar ne koopëratve bujqesore) d.m.th. 12.000 leke ne muaj.
15. Për rastet kur i verbëri kryen veprime të qellimshme për të përfituar verbërine si:
 - ☞ Fallsifikim i dokumentave të verbërise, deshmive pa dëftesa
 - ☞ Refuzim i punësimit
 - ☞ Refuzim i kualifikimit
 - ☞ Mosparaqitja e dëshmise pas mbarimit të dy kurseve të kualifikimit.

Atëhere personi i verbër për jashtohet nga skema e përfitimit për shkak të verbërise, i merret librezja e verbërise për nje periudhe deri ne 3 vjet dhe i nënshtrohet sanksioneve të përcaktuara në pikën 15 të VKM Nr. 277 datë 18.06.1997.

16. Kur personi i verbër merr pagese të padrejtë me mungese të plotë ose të pjeseshme dokumentacioni, veçanërisht të librezes së verberise që perseritet çdo vit, administratori shoqëror mban përgjegjësi, për shkelje të disiplinës së punës dhe asaj financiare.
17. Fondet e pagesave të pensioneve të invaliditetit të atyre personave që përfitojnë nga ligji 8098 datë 28.03.1996 "Për Statusin e të Verbërit" mbulohen nga sigurimet shoqërore, ndërsa fondet e pagesave të verbërise dhe kujdestarise të personave që për fitojnë nga ky ligj akordohen nga Shërbimi Social Shtetëror.
18. Administratori shoqëror tërheq me proces-verbal çdo muaj dokumentat që lëshon KMPV-ja mbi bazën e proces-verbalit të firmosur nga përfaqësuesit për të dy palet.
19. Personat që përfitojnë sipas Statusit të të Verbërit, sipas vendimeve të KMPV të cilet duhet të rikomisionohen nga keto komisione pas datës 01.01.2001, do të vazhdojnë të marrin pagesen që rrjedh nga përfitimi i stasisit të mëparshëm deri në komisionimin tjetër sipas njoftimit të SHSSH. Shërbimi Social Shtetëror harton grafikun dhe njofton përfituesit për datën e rikomisionit të tyre.
20. Udhëzimi 1881/3 datë 07.11.2002 "Për zbatimin e VKM nr.277 datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit" shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin efektin financiarë nga data 01.09.2003.

VALENTINA LESKAJ

MINISTER



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr.8626, datë 22.6.2000

**STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK
DHE TETRAPLEGJIK**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

NENI 1

Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit.

NENI 2

Në kuptimin e këtij ligji:

1. "Paraplegjik" nënkupton çdo person që vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme.
2. "Tetraplegjik" nënkupton çdo person, që vuan nga paraliza e katër anësive si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme dhe i klasifikuar si i tillë me vendimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

NENI 3

Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive.

Ministria e Shëndetësisë parashikon çdo vit në buxhetin e shpenzimeve të saj fondet e nevojshme për kontrole periodike vjetore nga mjek të specializuar për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

NENI 4

Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes.

NENI 5

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.

Kriteret e dhënies së dëshmisë dhe forma e saj përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe të Shërbimeve Sociale.

NENI 6

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta. Në rastet kur ata vetëpunësohen si persona fizikë dhe janë subjekte të tatimit mbi biznesin e vogël, kuota e tatimit fiks është sa gjysma e asaj të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 "Për tatimin mbi biznesin e vogël".

NENI 7

Personat juridikë, shtetërorë ose privatë që punësojnë të sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përveç kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.7955, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", përfitojnë për çdo vit kalendarik ulje tatimi mbi fitimin, të barabartë në përqindjen e fuqisë punëtore të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Ministria e Financave nxjerr aktet nënligjore përkatëse në bazë të këtij ligji.

NENI 8

Shteti favorizon arsimimin e të sëmurëve paraplegjikë në shkollat e larta të sistemit shtetëror. Këshilli i Ministrave merr masa dhe përcakton fonde për ngritjen e shkollave dhe të institucioneve për arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

NENI 9

Shteti i përjashton të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga pagesat për sigurimin shëndetësor dhe u jep atyre të drejtën e përfitimit falas të barnave për sëmundjen, pasojë e invaliditetit.

NENI 10

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që janë në gjendje të rëndë dhe në pamundësi për t'u paraqitur në institucionet shtetërore, përfitojnë shërbimin në banesë nga mjeku i familjes dhe mjeku specialist për ato procedura mjekësore që mund të kryhen në mënyrë ambulatorë dhe në kushte shtëpie. Ministria e Shëndetësisë nxjerr aktet nënligjore përkatëse për këtë qëllim.

NENI 11

Udhëtimi urban i të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, bashkë me shoqëruesin e tyre, bëhet falas në mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat, ndërsa udhëtimi interurban rimburohet nga shteti në masën 50 për qind të vlerës.

NENI 12

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë pajisen me telefon. Ata paguajnë tarifën telefonike të nivelit të parë, favorizuar për popullsinë e përcaktuar në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe përjashtohen nga tarifën e tjera. Diferencat paguhen nga shteti.

NENI 13

Shteti financon veprimtaritë e organizuara nga shoqatat e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim në buxhetin e shtetit.

NENI 14

Shteti merr përsipër të vërë në dispozicion dhe të japë falas mjedise për zhvillimin e veprimtarisë së shoqatës të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

NENI 15

Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga të ardhurat që përfitojnë nga shteti, marrin një shtesë në të holla për shkak të paralizës së tyre, në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Kjo shtesë nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekte të nivelit ekonomik. Invalidët kanë të drejtë për një pagesë, po në këtë masë, për kujdestarin e tyre, të zgjedhur sipas procedurave ligjore.

NENI 16

Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale administron mjetet e përshtatura për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Kriteret përcaktohen me rregullore nga Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale.

Personat e sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat doganore për mjete, të cilat ndihmojnë në integrimin e tyre në jetë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre.

NENI 17

Shteti merr përsipër trajtimin me përparësi me strehim, nëpërmjet kredive të dhëna me kushte lehtësuese për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

NENI 18

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit përcakton tarifat e reduktuara të konsumit të energjisë elektrike për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

NENI 19

Ministria e Shëndetësisë merr masa që në spitalet e nivelit të dytë dhe të tretë të përshtaten dhe të pajisen një deri dy dhoma për shtrimin eventual të të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjik.

NENI 20

Në vende publike (aerporte, stacione treni, stadione, hotele etj.) krijohen mjedise për lëvizjen, qëndrimin dhe shërbimin për të sëmurët paraplegjikë sipas ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit".

NENI 21

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 6, 9, 11, 12, 13, 14, 16, 17 dhe 19 të këtij ligji.

NENI 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

SKËNDER GJINUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr.9506, datë 3.4.2006

**PER NJE NDRYSHIM NE LIGJIN 8626, DATE 22.06.2000
“PER STATUSIN E INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK” TE NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Ne ligjin nr.8626, date 22.06.2000 “Per statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, te ndryshuar, behet ky ndryshim:

NENI 1

Neni 9 ndryshohet si me poshte:

“Neni 9

Shteti perjashton te semuret paraplegjike dhe tetraplegjike nga pagasat per kontributet shendetesore dhe u jep te drejten e perfitimit falas te barnave, te mbuluara nga skema e sigurimeve te kujdesit shendetesor.

Paraplegjiket dhe tetraplegjiket, te cilet kane perfituar statusin, perfitojne nje shtese ne te ardhura per mbulimin e shpenzimeve te paketes se

domosdoshme me materiale te veçanta higjeno-sanitare. Masa, kriteret dhe proceduart e perfitimit te kesaj shtese ne te ardhura percaktohen me vendim te Keshillit te Ministrave”

NENI 2

Ky vendim hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARE

JOZEFINA TOPALLI (ÇOBA)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr.31, datë 20.1.2001

PER

**PERFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK
DHE TETRAPLEGJIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenti 21, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni mjekësor i caktimit të aftësive për punë (KMCAP), në rreth, shqyrton të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat e interesuar, që përfitojnë nga ligji nr. 8626, datë 22.6.2000, pavarësisht nga mosha, nga fakti nëse janë ose jo në marrëdhënie pune, nga koha a vendndodhja e absent apo nga çasti i sigurimit.

Komisioni vendos edhe shkallën e invaliditetit, sipas ndarjes që vijon:

- I. Grupi i parë, ku përfshihen:
 - a) të sëmurët tetraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.
 - b) të sëmurët paraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 përqind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.
- II. Grupi i dytë, ku përfshihen të sëmurët paraplegjikë, pjesërisht të aftë për punë të përzgjedhur, që janë në gjendje për të vetëshërbyer.

2. KMCAP-ja i lëshon të interesuarit raportin mjekësor, duke përcaktuar shkallën e paaftësisë dhe nevojën për kujdestar. Invalidi, paraplegjik ose

tetraplegjik, duhet të deklarojë para administratorit shtetëror emrin e kujdestarit i cili shënohet në një regjistër të veçantë. Ndërrimi i kujdestarit mund të bëhet sa herë që invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, e sheh të arsyeshme, por është i detyruar të njoftojë menjëherë KMCAP-në.

3. Invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.

4. Masa e pagesës për invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë, dshtë 70 për qind e pagës minimale të punonjësit buxhetor dhe nëryshon sa herë nëryshon kjo pagë. Pagesa përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat e tjera, që invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, përfiton nga shteti. Të njëjtën pagesë përfiton edhe kujdestari i invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi.

Vendi dhe mënyra e dhënies së këtyre pagesave do të përcaktohet në udhëzimin, që do të dalë në zbatim të këtij vendimi.

5. Efektet financiare për këto pagesa të përballohen brenda fondeve të dhëna për vitin 2001, Administratës së Përgjithshme të ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, në zërin "Përfitim paaftësie".

6. Personat që do të fitojnë statusin e invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, para datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë, në zbatim të pikës 4 të këtij vendimi, që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik ose tetraplegjik" Të gjithë personat e tjerë që do ta fitojnë këtë status pas datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë një muaj pas daljes në KMCAP.

7. Për çdo shpërdorim, personit përgjegjës i merret dëshmia për një periudhë deri në 3 vjet dhe, sipas rastit, zbatohen edhe dispozitat për kundërvajtjet administrative deri në kallëzim për njëkëje penale.

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

ILIR META



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr.619, datë 7.09.2006

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRFITIMET
NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005, "Për buxhetin e shtetit, të vitit 2006", me propozimin e ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Paragrafi i parë, i pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCA) në rreth shqyrton të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat e bërë paraplegjikë apo tetraplegjikë, për shkaqe që lidhen me punësimin, të cilët përfitojnë nga ligji nr.8626, datë 22.6.2000".
 - b) Paragrafi i parë, i pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Masa e pagesës për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që janë bërë të tillë për shkaqe që lidhen me punësimin, është 6 800 (gjashtë mijë e tetëqind) lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës

minimale në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat, që ata përfitojnë nga shteti. Të njëjtën pagesë përfiton edhe kujdestari i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1, të këtij vendimi”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për pagesën e paaftësisë, për vitin 2006, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki/komuna) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2006.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNES, ÇESHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TE BARABARTA
MINISTRI

Adresa Rruga e Kavajes, nr 53, Tirane, Tel 0355 4 228340

UDHEZIM

Nr.1957, datë 19.09.2006

MBI ZBATIMIN E VKM, NR. 619, DATË 07.09.2006,
“PER DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR. 31,
DATE 20.1.2001, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE,
“PER PERFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT,
PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK”, TE NDRYSHUAR”

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr.619, datë 07.09.2006, “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 31, datë 20.01.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr.245, datë 27.04.2006, “Për përcaktimin e pagës minimale për vitin 2006”;

UDHEZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 1, germa “b”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 619, datë 07.09.2006, është 8.000 (tetëmijë) lekë në muaj.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektin nga 01.09.2006.

KOÇO BARKA

MINISTER



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr.78, datë 07.02.2007

PËR

**MASËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT
TË NJË PAKETE TË VEÇANTË HIGJIENO-SANITARE,
PËR INVALIDËT PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006, "Për buxhetin e shtetit, të vitit 2007", me propozimin e ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe të ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët e kanë përfituar këtë status me vendim të komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë për punë (KMCAP) dhe që vlerësohen se kanë humbje të plotë të sensibilitetit dhe të motorrikës nga niveli i dëmtimit, poshtë, në të dyja anësitë, përfitojnë një pagesë shtesë, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj, për mbulimin e paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare.
2. Pagesa shtesë, që përfitohet sipas pikës 1, të këtij vendimi, tërhiqet në zyrën e njësisë së qeverisjes vendore, ku paraplegjikët dhe tetraplegjikët përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar.
3. Për të përfituar këtë pagesë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të dalin në KMCAP, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2007, zëri “Transferta të familjeve dhe të individëve”, grupi 25, titulli 064, kapitulli 1, artikulli 606, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr.8153, datë 31.10.1996

PER STATUSIN E JETIMIT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

VENDOSI:

NENI 1

Përfitojnë statusin e jetimit personat me moshë nga 0-25 vjeç, që kanë kaluar ose jo nëpër institucione shtetërore a private të përkujdesit shoqëror dhe që plotësojnë këto kritere:

- a) të lindurit jashtë martese;
- b) që nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit;
- c) të cilëve me vendim të formës së prere të gjykatës u është hequr e drejta prindërore e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton;
- d) që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre.

NENI 2

Personat që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 1, përfitojnë nga ky status edhe pasi kanë kaluar moshën 25 vjeç, nëse nuk janë trajtuar nga shteti

me strehim dhe janë në kushte të veshtira jetese. Kriteret për trajtimin e tyre dhe afatet kohore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 3

Vendosja e fëmijëve jetimë në institucionet shtetërore ose private të përkujdesit shoqëror bëhet sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

NENI 4

Institucionet që trajtojnë jetimë, duke përfshirë dhe ato arsimore, janë të detyruara që me mbarimin e vitit të parafundit të shkollës të dërgojnë statistika të sakta pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, si dhe pranë zyrave të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror në bashki e komuna, me qëllim që të merren masa për sistemimin e tyre me punë dhe strehim sipas rregullave të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

NENI 5

1. Jetimët në institucionet shtetërore ose private të përkujdesit shoqëror mbahen deri në moshën 14 vjeç. Në rastet kur fëmija brenda kësaj moshe nuk ka mundur të kryejë shkollën 8-vjeçare mbahet deri në moshën 17 vjeç. Pas kësaj moshe zbatohet neni 6 për ata që fitojnë stratusin e jetimit.

2. Me mbarimin e shkollës 8-vjeçare drejtorja e institucionit të përkujdesit shoqëror, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe organet e pushtetit lokal, planifikon për jetimin të drejtë studimi sipas prirjeve dhe aftësive. Këtyre personave u jepet bursë e plotë nga shteti, sipas kriterëve që përcaktohen me akte nëligjore.

NENI 6

Bursa dhe trajtimi me veshmbathje për vitet e shkollës së mesme dhe të lartë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 7

Për jetimët që mbarojnë shkollën e mesme ose të lartë dhe që jetojnë në konvikte, shpenzimet e ushqimit përballohen nga zyrat e ndihmës dhe të përkujdesit shoqëror në bashki e komuna, deri në zënieën e tyre me punë.

NENI 8

Jetimët që vazhdojnë shkollat e mesme a të larta për periudhën e pushimeve verore, trajtohen me një pagesë suplementare që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

NENI 9

Shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet për jetimët, të cilët nuk janë në marrëdhënie pune, sigurohen falas nga shteti. Për këtë Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit nxjerr aktet nëligjore përkatëse.

NENI 10

Udhëtimi me mjetet e transportit shtetëror a privat qytetas, si dhe ndërqytetas i jetimëve, që s'janë në marrëdhënie pune bëhet falas. Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë nxjerr për këtë aktet nëligjore përkatëse.

NENI 11

Për jetimët e vendosur në institucionet e përkujdesit shoqëror sigurohet hyrja në shfaqje, spektakle, veprimtari sportive etj., me 50 për qind të vlefes së biletës. Për këtë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nxjerr aktet nëligjore përkatëse.

NENI 12

Punësimi i jetimëve bëhet me përparësi nga zyrat e punës e përkujdesjes sociale.

NENI 13

Jetimët e punësuar trajtohen me përparësi nga punëdhënësi, duke krijuar mundësi për mbajtjen në punë gjatë procesit të shkurtimit të veprimtarisë.

NENI 14

Jetimët trajtohen me përparësi në emigracionin e organizuar nga shteti. Në këto raste përjashtohen nga taksat.

NENI 15

Personave që fitojnë këtë status de shkojnë për të kryer shërbimin e detyruar ushtarak, u jepet nga shteti një kuotë suplementare që caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 16

Djemtë jetimë që mbarojnë shërbimin ushtarak sistemohen me strehim e punë nga bashkitë e komunat në bazë të kërkesës së bërë 6 muaj më parë nga kryesia e shoqatës. Në rast të kundërt, sistemohen në konvikte. Shpenzimet e ushqimit përballohen nga zyrat e ndihmës dhe përkujdesit shoqëror deri në zënien e tyre në punë.

NENI 17

Strehimi i personave që përfitojnë nga ky status bëhet me përparësi dhe me kredi afatgjata nga shteti, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr.8030, datë 15.11.1995 "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", si dhe aktet nënligjore përkatëse. Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore përkatëse.

NENI 18

1. Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së Jetimëve Shqiptarë sipas mundësive financiare të planifikuara për këtë qëllim.

2. Të gjitha ndihmat humanitare, si me fonde ashtu edhe me materiale për jetimët, livrohen nëpërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim edhe me Shoqatën e Jetimëve.

3. Mjediset që shteti vë në dispozicion të Shoqatës së Jetimëve për të zhvilluar veprimtarinë e saj, jepen në përdorim pa shpërblim.

NENI 19

Pranë Komitetit Shqiptar të Birësimeve merr pjesë dhe një përfaqësues i Shoqatës së Jetimëve.

NENI 20

Këshilli i Ministrave ngarkon ministrinë përkatëse për zbatimin e këtij ligji, në bashkëpunim me komisionin qendror që do të ngrihet pranë kësaj

ministrie. Mënyra e krijimit dhe e funksionimit të komisionit qendror rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

NENI 21

Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

NENI 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1634, datë 11.11.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.